



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:226109
Datë: 10.11.2023
Numri i dokumentit: 04901602

C.nr. 1005/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rita Basha, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.K, nga fshati Zatriq, Komuna e Rahovecit, kundër të paditurës “S” me seli në Prishtinë, për shkak të objektit të kontestit – kompensimi i dëmit, vlera e objektit të kontestit 2.500,00 euro, më datën 10.11.2023 merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET E TËRHEQUR padia e paditësit H.K, nga fshati Zatriq, Komuna e Rahovecit, kundër të paditurës “S” me seli në Prishtinë, në çështjen juridike kontestimore, C.nr. 1005/2021.

Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi H.K, pranë kësaj gjykate më datë 07.10.2021, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar padinë kundër të paditurës “S” me seli në Prishtinë, për shkak të objektit të kontestit – kompensimi i dëmit, vlera e objektit të kontestit 2.500,00 euro.

Lidhur me këtë çështje kontestimore, gjykata i ka dërguar ftesë për seancë të autorizuarit të paditësit “I” Prishtinë, për datën 08.11.2023, ku nga fletë kthesa konstatohet se të njëjtën e kanë pranuar me datë 28.09.2023. Gjykata gjithashtu i ka dërguar ftesë edhe të paditurës “S” me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson “A” Prishtinë, e që nga fletë kthesa konstatohet se të njëjtën ftesën e kanë pranuar me datë 29.09.2023. Ndërkaq me datën 08.11.2023 është mbajtur seanca përgatitore, ku përkundër faktit se palët ndërgjyqëse ftesën e kanë pranuar në mënyrë të rregullt, të njëjtën nuk janë paraqitur në seancën përgatitore të datës 08.11.2023 dhe as nuk e kanë arsyetuar mungesën e tyre. Në këtë drejtim sipas nenit 409.1 të LPK-së “*Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet.*”

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë t'i bartë këto shpenzime, është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së pasi që secila palë paraprakisht vet i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në bazë të nenit 409.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.1005/2021 me datën 10.11.2023

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.